VENDIM
Nr.581, datë 8.12.1999

PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË OFERTAVE PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË ANONIME "AMC"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7 dhe 9, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998, "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë" dhe të nenit 5, të ligjit nr.8515, datë 21.7.1999, "Për privatizimin e shoqërisë anonime "Albania Mobile Communication (AMC)", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Vlerësimi i ofrtave të detyrushme, që do të paraqiten nga investitorët strategjikë, të cilëve u ofrohet paketa e aksioneve të kapitalit të shoqërisë anonime 'AMC", dhe përcaktimi i pikëve të vlerësimit të ofertave, kryhet duke marrë për bazë kriteret sopas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE TË AMC SH.A
TABELA E KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE PËR PRIVATIZIMIN E AMC SH.A.

	Totali	Pjesë
1.Kredencialet e blerësit & Aftësia teknike	20	10
Interesi strategjik		
1.2 Aftësitë teknike		
2.Plani i biznesit	150	
2.1Tregu & Shërbimet	50	
2.1.1.Pajtimtare		10
2.1.2.Shërbime rinovuese		10
2.1.3.Tarifat dhe çmimi		20
2.1.4.Marketing/Shërbimet ndaj klientëve		10
2.2 Rrjeti	40	
2.2.1.Popullsia që mbulon		20
2.2.2Territori që mbulon		10
2.2.3.Përmirësimet teknike		5
2.2.4.Mirëmbajtja		5
		10
2.3 Aspekte ekonomike & Financiare	15	
2.3.1.Huatë e marra për zhvillim		10
2.3.2.Masat për rastet e vështirësive që mund të lindin		5
2.4.Të tjera	45	
2.4.1.Plani i investimit		40
2.4.2.Faktori shqiptar		5
3.Oferta financiare	800	
3.1.Vlerësimi		800
3.1.1.Çmimi		
4.Marrëveshja e blerjes	30	
4.1.Deklarimet dhe garancitë e blerësit dhe të shitësit		10
4.2.Niveli i dëmshpërblimit për të cilin është përgjegjës		20

shitësi		